



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2020, nr. 01-400/-03-0075925/19, datë 23.09.2019, bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

➤ PROGRAMI PËR USHQIM TË PEMËVE FRYTORE NË FORMË TË LËNGËT DHE PLUHURIT

(Projekti do të realizohet në bashkëpunim me përfituesit)

Subvencionimi në projektin e cekur realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e fermerëve përfitues.

Fermerët përfitues do të marrin pjesë me **30%** të vlerës së projektit.

Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me **70%** të vlerës së projektit.

Fermerët përfitues para lidhjes së kontratës do të paguajnë **30%** të vlerës së kontratës në llogarinë bankare të Komunës.

Përfitues : Njëqind (100) fermer

KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banor i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit)
- Skica e planit të mjelljes së pemëve
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Dëshmia e sipërfaqes së mbjellur me pemishte mbi 50 ari;
- Secila pemishte duhet të jetë e pajisur me sistem pikë - pikë.
- Afati i aplikimit: nga data 01.06.2020 deri më 13.06.2020.
- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i ri i Komunës, kati përdhësë, në sportel.

Nr.prot. 12-326/01-0024552
Podujevë, 01.06.2020



Drejtori
Vezir Januzi